



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 755/2 prot.,

Datë 11.04.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur – Shërbime, marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-60211-02-23-2023, me objekt: “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh ndarë në 3 (tre) Lote”, me fond limit 16.999.333 lekë pa TVSH, Loti 2, me numër reference Nr. REF-60216-02-23-2023, me objekt: “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës”, me fond limit të lotit 3.000.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 16.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Ankimues: “Auto Manoku Servis” SHPK
Adresa: Rruga “Nozllaku”, Godine 2-katëshe, Kati 1, Zona Kadastrale 3866, Nr. Pasurie 287/28, Yrshek, Kashar Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara
Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë.

Në datën 07.04.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 755/2023 protokoll dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3005, e operatorit ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur – Shërbime, marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-60211-02-23-2023, me objekt: “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh ndarë në 3 (tre)

Lote”, me fond limit 16.999.333 lekë pa TVSH, Loti 2, me numër reference Nr. REF-60216-02-23-2023, me objekt: “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës”, me fond limit të lotit 3.000.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 16.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 755 prot., datë 07.04.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

- • Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 7, seksioni 2.3 “Kapaciteti teknik” të Kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi në tabelën e paraqitur nuk ka specifikuar vendin e origjinës, si dhe certifikimet të lëshuara nga një organ i akredituar në lidhje me të gjitha Agregatet/Pajisjet/Pjesët e këmbimit që do të përdoren gjatë realizimit të shërbimeve të përcaktuara në shtojcën 6 “Formulari i Shërbimeve dhe Grafiku i ekzekutimit”. Konkretisht nuk ka specifikuar vendin e origjinës, si dhe certifikimet e lëshuara nga një organ i akredituar, në lidhje me zërin nr. 2 “Sistemi i Ushqimit”, pika 2 “Furnizim vendosje pompe nafte elektrike” për Llojin e mjetit: Mikrobus, Marka: Ford, Tipi: Tourneo Custom, Viti prodh: 2019 Nr.Shasisë: WF01XXTTG1KM28569, Lënda djegëse: Naftë”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 11.04.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri